


Raport per

# MONITORIMIN E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR

janar - korrik 2023



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Instituti për të drejtat e njeriut

**Titulli:**

**RAPORT PËR MONITORIMIN E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË SË VERIUT  
për periudhën janar - korrik 2023**

**Botues:**

**Shoqata e qytetarëve Instituti për të drejtat e njeriut Shkup**

**Skopje, gusht 2023**

---

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.  
Përmbajtja e tij në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropia.

# PËRMBAJTJE

---

<b>HYRJE</b> .....	<b>4</b>
<b>TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR</b> .....	<b>4</b>
Votimi dhe sistemi i regjistrimit të zërit .....	5
Seancat publike të KGJRMV-së .....	5
Raporte vjetore mbi punën e KGJRMV-së .....	6
Analizë e përmbajtjes së publikimeve dhe deklaratave për media të Këshillit Gjyqësor ...	7
Hapja ndaj publikut dhe mediat.....	7
<b>EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR</b> .....	<b>9</b>
Shkarkimi dhe zgjedhja e kryetarit të KGJRMV-së.....	9
Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve .....	11
Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.....	13
Shkarkimi i gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.....	16
Monitorimi i punës së gjykatave.....	17
Vendimmarrja në bazë të ankesave nga qytetarët dhe personat juridikë .....	18
<b>PËRFUNDIME</b> .....	<b>19</b>
<b>REKOMANDIME</b> .....	<b>21</b>

# HYRJE



janari - korrik  
2023

Instituti për të Drejtat e Njeriut, nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha seancat e hapura, rregullisht monitoron punën e Këshillit Gjyqësor. Qëllimi i këtij aktiviteti është që, duke monitoruar objektiviisht punën e Këshillit Gjyqësor, Instituti për të Drejtat e Njeriut të evidentojë sfidat dhe progresin në punën e tij, si dhe të kontribuojë, me konkluzione dhe rekomandime të bazuara në prova, në përmirësimin e situatës në gjyqësor. Ky aktivitet realizohet në kuadër të programit “Qasje në drejtësi për të gjithë”, financuar nga Bashkimi

Evropian në kuadër të programit IPA III për shoqërinë civile dhe mediat 2021.

Ky raport është i ndarë në tri pjesë kryesore të cilat lidhen respektivisht me **transparencën**, **efektivitetin** dhe **efikasitetin** e Këshillit Gjyqësor.



Për qëllimet e këtij raporti janë përdorur këto burime informacioni: pjesëmarrja në të gjitha seancat e hapura të Këshillit Gjyqësor, procesverbalet dhe raportet e Këshillit Gjyqësor, publikimet dhe dokumentet e publikuara në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor, publikime nëpër media etj.

## TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR



ka zhvilluar  
26 seanca

Në këtë periudhë të caktuar kohore, KGJRMV ka zhvilluar **26 seanca**, nga të cilat **4 me dy vazhdime**.

Periudha kohore gjatë së cilës është monitoruar puna e KGJRMV mund të ndahet në dy pjesë: (1) nga janari deri në mes të prillit 2023 dhe (2) nga mesi i prillit deri në fund të korrikut 2023.

Në muajt e parë, deri në mes të prillit 2023, është konstatuar publikim i vazhdueshëm dhe në kohë i **njoftimeve për mbajtjen e seancave dhe publikim i njoftimeve për vendimet dhe konkluzionet e marra, menjëherë pas përfundimit të çdo seance**. Është respektuar detyrimi ligjor për publikimin e procesverbaleve të seancave të KGJRMV, si dhe pas miratimit të tyre janë publikuar procesverbalet në formë të detajuar. **Dinamika e miratimit dhe publikimit të tyre është përmirësuar, përkundër periudhës së njëjtë vitin e kaluar (periudha raportuese janar-korrik 2022)**. Në secilën nga seancat në të cilat janë miratuar procesverbalet, anëtarët kanë bërë vërejtje në pjesë të caktuara, duke specifikuar pretendimet e tyre të bëra gjatë diskutimeve në lidhje me pikat e rendit të ditës, me qëllim interpretimin më të hollësishëm të diskutimeve.

**Në tre muajt e parë të vitit 2023, ka pasur një prani më të madhe publike të ish-kryetares së KGJRMV - Vesna Dameva**, përmes pjesëmarrjes në ngjarje publike, dhënies së deklaratave dhe intervistave në media, pjesëmarrjes në transmetime ose informim të publikut për takimet e saj me ambasadorët dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, dhe sektorin e OJQ-ve, si rezultat i bashkëpunimit intensiv me ta gjatë asaj periudhe.

**Pas 26 prillit 2023**, kur ish-kryetarja e KGJRMV-së - Vesna Dameva - u shkarkua në procedurë të paligjshme, **mund të vihet re shkelje e qartë e transparencës në punën e KGJRMV-së**, madje edhe në procedura, të cilat janë të përcaktuara qartësisht në ligj se duhet të jenë publike dhe transparente.

Edhe pse në çdo seancë ka pasur prezencë të madhe të mediave, të cilat edhe kanë incizuar, pas ngjarjes së shkarkimit të ish-kryetares Vesna Dameva dhe pas trajtimit të papërshtatshëm të anëtarëve të KGJRMV-së ndaj publikut, **është prezantuar praktika që seancat e KGJRMV-së të transmetohen drejtpërdrejt nga MIA**. Kjo praktikë u krijua për shkak se pas seancës ku u shkarkua ish-kryetarja Vesna Dameva, anëtarët zhvilluan seanca për të cilat nuk ka pasur njoftim paraprak, si rrjedhojë publiku, për shkak të mungesës së informacionit, nuk ka pasur mundësi të marrë pjesë. Në këto seanca janë ndërmarrë një numër masash, të cilat sipas ligjit duhet të ishin publike, veçanërisht vendimet e marra në ato seanca.

Zgjedhja e kryetarit të ri u zhvillua nën presionin e madh të publikut dhe OJQ-ve. Pavarësisht përpjekjes së kryetarit të ri Sashko Georgiev për të vënë kontakt të drejtpërdrejtë dhe transparent me publikun dhe sektorin e OJQ-ve, trajtimi i gazetarëve nga ana e tij, veçanërisht ndaj kameramanëve, në seancën e parë pas zgjedhjes së tij çoi deri në pikën që çdo seancë të transmetohet drejtpërdrejt nga agjencia MIA.



## VOTIMI DHE SISTEMI I REGJISTRIMIT TË ZËRIT

Në një periudhë të caktuar pas shkarkimit të ish-kryetares Vesna Dameva, **mund të vihej re se sistemi elektronik për votim dhe regjistrim të zërit nuk ishte në funksion**, ndryshe nga periudha e mëparshme, si rrjedhojë anëtarët nuk votonin përmes sistemit të votimit. Në përputhje me Rregulloren e punës së KGJRMV-së, kjo është mënyra e rregullt e votimit, dhe nëse ndonjë nga anëtarët ka dyshime për rezultatin, ka mundësi të kërkojë të votohet duke ngritur dorën. Mirëpo, as ish-nënkryetari Selim Ademi, i cili udhëhiqte seancat deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, as kryetari i ri Sashko Georgiev, nuk shpjeguan se pse sistemi nuk ishte funksional pikërisht në atë periudhë.



## SEANCAT PUBLIKE TË KGJRMV-SË

Sa i përket dinamikës së mbajtjes së seancave, në bazë mujore, **nuk ka ndryshime të dukshme në krahasim me raportin e mëparshëm**, por mund të konstatohet se pas zgjedhjes së kryetarit të ri Sashko Georgiev, janë caktuar seanca urgjente, të cilat, për nga përmbajtja e tyre dhe nuk kanë karakter urgjent, por kryesisht bëhet fjalë për pika të rendit të ditës, të cilat duhen shqyrtuar dhe vendosur në seanca të rregullta. Një arsye e mundshme për këtë është koordinimi pamjaftueshëm i brendshëm midis kryetarit dhe shërbimit profesional të KGJRMV-së, ose shmangia e pranisë publike në vetë seancat. Një seancë brenda muajit është gjithmonë e rezervuar për të vendosur mbi ankesat e qytetarëve dhe subjekteve juridike, e cila është gjithashtu një detyrim ligjor.

Tipike për mënyrën e punës së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor është mbajtja e kolegji-umeve, por në periudhën pas shkarkimit të kryetares së mëparshme, kolegji-umet janë mbaj-

tur kryesisht menjëherë para seancave publike. Një mënyrë veçanërisht e papërshtatshme e mbajtjes së kolegjiut ishte pas seancës ku u shkarkua ish-kryetarja Vesna Dameva. Në këtë rast mbajtja e kolegjiut mori përmasat e një seance në të cilën Këshilli Gjyqësor mori vendime të rëndësishme, për të cilat publiku u informua pas përfundimit të seancave, gjë e cila mund të shihet nga radha e publikimit të njoftimeve në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor. Meqenëse këto kolegjiute mbahen para vetë seancës, shkaktohet vonesë në fillimin e seancave publike.

Puna e anëtarëve të KGJRMV-së në seanca mund të karakterizohet si mjaft dinamike, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve në diskutime dhe debatet rreth pikave të rendit të ditës, duke përdorur të drejtën e replikës, argumentimit, justifikimit, me interpretime të ndryshme të situatave të caktuara që janë diskutuar më parë dhe mbi të cilat tashmë janë nxjerrë konkluzione, ose duke specifikuar disa procedura që nuk janë shpjeguar sa duhet me ligj ose akte nënligjore. Por ndonjëherë ka diskutime më intensive, të cilat, në disa raste, përfundojnë me largimin e anëtarëve të caktuar nga seanca. Kjo situatë ishte intensive në periudhën menjëherë para shkarkimit të ish-kryetares, si dhe në periudhën pas zgjedhjes së kryetarit të ri, në mënyrë që tensionet midis anëtarëve të mund të lehtësoheshin pas dorëheqjeve të dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve dhe pas kritikave nga OJQ-të.



## RAPORTE VJETORE MBI PUNËN E KGJRMV-SË

Raporti vjetor i punës së KGJRMV-së, për vitin 2021, u miratua më 20.3.2023<sup>1</sup>, pa asnjë vërejtje, megjithëse u diskutua edhe në Komisionin për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndër-Komunitare, si dhe në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Raporti vjetor për punën e KGJRMV-së për vitin 2022 është dorëzuar në Kuvend brenda afatit të përcaktuar ligjërisht<sup>2</sup>, por ende nuk është shqyrtuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Prania e anëtarëve, sipas funksionit, në seancat e KGJRMV-së

Ministri i drejtësisë dhe kryetari i Gjykatës Supreme të RMV (GJSRMV) në Këshillin Gjyqësor janë anëtarë sipas funksionit, por nuk marrin pjesë fare në seanca, edhe pse Ministri i ri i drejtësisë - Krenar Lloga tregoi interes të konsiderueshëm në zgjidhjen e situatës rreth shkarkimit të paligjshëm të ish-kryetares Vesna Dameva. Ai gjithashtu propozoi një sërë masash, megjithëse deri më tani nuk ka veprime më specifike nga ana e tij.

Edhe pse ministri i drejtësisë ka vite që nuk merr pjesë në seanca, pjesëmarrja e tij në seanca individuale do të ishte e një rëndësie të veçantë. Kjo praktikë e mospjesëmarrjes zbatohet pas kritikave të faktorit ndërkombëtar se ka pasur ndikim nga ministri në punën e Këshillit Gjyqësor. Por duke qenë se ministri është anëtar sipas funksionit, kohabitimi i tij me Këshillin Gjyqësor është i domosdoshëm për bashkëpunim pa pengesa në zbatimin e reformave gjyqësore, për më tepër që në proces është përgatitja e një Strategjie për reformën e gjyqësorit 2023-2027, ku ministri i drejtësisë paraqitet si propozues i ligjeve të rëndësishme në fushën e drejtësisë. Kryetarja e GJSRMV-së e arsyetoi mungesën e saj për faktin se është shumë e zënë, por gjatë periudhës kur merrte pjesë në seanca, (para

1 <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=09071688-ecc3-4dd7-88a4-6b2642967dc4>

2 <https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=39a30df8-b2ac-4133-a706-915071aa5a7c>

shkarkimit të kryetares së mëparshme Vesna Dameva), **kontribuonte në punën e Këshillit Gjyqësor**. Sipas legjislacionit, kryetarja e GJSRMV-së nuk ka të drejtë vote në seanca, megjithatë prania e saj nënkupton se mund të diskutohen çështje të rëndësishme dhe të shkëmbehen përvoja që e ndikojnë punën e Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme, por edhe gjyqësorit në përgjithësi. Për këtë arsye synimi i ligjvënësit është të lidhë këto dy institucione të rëndësishme gjyqësore me situatat aktuale në gjyqësor përmes respektimit të parimeve të pavarësisë, paanshmërisë dhe transparencës.



## ANALIZË E PËRMBAJTJES SË PUBLIKIMEVE DHE DEKLARATAVE PËR MEDIA TË KËSHILLIT GJYQËSOR

Me zgjedhjen e kryetarit të ri Sashko Georgiev, KGJRMV gjithashtu punësoi një zëdhënës të ri, një gazetar me përvojë të gjerë gazetareske dhe që ndjek gjyqësorin. Nga monitorimi i faqes së internetit të Këshillit Gjyqësor, mund të konstatohet se edhe gjatë kësaj periudhe ka pasur publikim të rregullt të njoftimeve për dhe nga seancat, përveç disa seancave për të cilat rendi i ditës është publikuar në ditën e mbajtjes së seancës, me shpjegimin se ato janë thirrur urgjentisht. Vazhdojnë të publikohen **njoftime për takimet dhe veprimtaritë ku marrin pjesë kryetari dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor**. Gjithashtu, zëdhënësja e re e KGJRMV-së ka filluar një praktikë me organizimin e informimeve për gazetarët, gjë që përmirëson komunikimin e Këshillit Gjyqësor me publikun.



## HAPJA NDAJ PUBLIKUT DHE MEDIAT

Gjatë periudhës kur u monitorua puna e KGJRMV-së, u evidentuan disa zhvillime të rëndësishme, si rrjedhojë prania e publikut në këtë periudhë ishte më e madhe. Gjegjesisht, që nga fillimi i vitit, ka pasur shumë pika interesante mbi të cilat është diskutuar në Këshillin Gjyqësor, e për të cilat edhe gazetarët ishin gjithashtu të interesuar. Kështu, përveç pranisë së vazhdueshme të përfaqësuesve nga sektori civil, **në seanca, më shpesh, kishte prani të gazetarëve që monitoronin dhe raportonin për punën e KGJRMV-së**. Interes i veçantë u shpreh për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta, për periudhën pas shkarkimit të ish-kryetares Vesna Dameva, për zgjedhjen e kryetarit të ri dhe për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit Gjyqësor etj.

Meqenëse në këtë periudhë raportuese ka pasur një prani të shtuar të mediave dhe gazetarëve në seancat e KGJRMV-së, kjo gjë ka pasur një ndikim të rëndësishëm në punën e anëtarëve të KGJRMV-së. **Nevoja për transparencë të shtuar, megjithatë, nuk duhet të ndikojë ose të shkaktojë shpërqendrim për anëtarët e KGJRMV-së në diskutimet mbi pikat e rendit të ditës**. Kjo për shkak se, veçanërisht gjatë mbajtjes së seancave, gazetarët duhet t'u përmbahen disa parimeve dhe standardeve të caktuara etike dhe të mos ndërhyjnë drejtpërdrejt në seancë dhe të bëjnë pyetje, të cilat, sipas ligjit, nuk duhet të jenë në dispozicion të publikut ose tashmë i janë paraqitur publikut. Në situata të caktuara, mungesa e njohurive të gazetarëve të caktuar për punën aktuale të KGJRMV-së dhe kompetencat e tij ndikon në cilësinë dhe rrjedhën e seancave.

Periudha e trazuar e Këshillit Gjyqësor ishte subjekt i kritikave nga publiku ekspert dhe OJQ-të të cilat shprehën shqetësimin e tyre për mënyrën joadekuate dhe jotransparente të punës së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, duke dënuar veprimet e tyre<sup>3</sup> dhe vendimet e marra dhe duke u bërë thirrje anëtarëve të japin dorëheqje për shkak të humbjes së legjitimitetit në sytë e publikut të gjerë, dhe mbi të gjitha në sy të autoriteteve gjyqësore. Kërkesa për dorëheqje të anëtarëve të KGJRMV-së u theksua veçanërisht nga OJQ-të.<sup>4</sup> Edhe pse dorëheqja është një akt personal, për të ruajtur besueshmërinë e KGJRMV-së si një organ që duhet të mbrojë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, është e nevojshme që puna e tyre të tregojë rezistencë të padyshimtë ndaj ndikimeve politike dhe veprimeve korruptuese.

---

3 Jordanovska, Meri. Ne stivnuvaat reakciite za razreshuvanjeto na Vesna Dameva, dopolnitelno se raskladuva doverbata vo sudstvoto. Meta, 28 prill 2023, shiko: <https://meta.mk/ne-stivnuvaat-reakciite-za-razreshuvanjeto-na-dameva-dopolnitelno-se-rasklatuva-doverbata-vo-sudstvoto/>. Më shumë rreth kësaj teme, shiko: Markovski, Hristo. Ne stivnuvaat reakciite po razreshuvanjeto na pretседателката на Судскиот совет, Vesna Dameva. 24 MK, 27 prill 2023, shiko: <https://24.mk/details/ne-stivnuvaat-reakciite-po-razreshuvanjeto-na-pretседателката-na-sudskiot-sovet-vesna-dameva> Dimovska, Mihaela. Реакции од експертската јавност по случувањата во Судскиот совет. Kanal 5 TV, 27 prill 2023, shiko: <https://kanal5.com.mk/reakcii-od-ekspertskata-javnost-za-sluchuvanjata-vo-sudskiot-sovet/a579418>. Veljanovska- Najdeska, Elizabeta. Реакции на пратениците за разрешување на претседателката на Судскиот совет, Dameva. MIA, 27 prill 2023, shiko: Реакции на пратениците за разрешување на претседателката на Судски совет Dameva ([mia.mk](http://mia.mk)). Kostadinovska, Paula. Реакции по разрешувањето на Dameva: Ново системско решение за избор на судии и обвинители. ALFA TV, 27 prill 2023, shiko: <https://alfa.mk/61585-2/>. Mirčeski, Vladimir. Реакции за начинот на избор на нов претседател на Судски совет. VOA, 5 maj 2023, shiko: <https://mk.voanews.com/a/7080164.html>

4 Блупринт група за реформи во правосудството. Reagimi ndaj ngjarjeve në Këshillin Gjyqësor të RMV-së, në: <http://blueprint.org.mk/%d0%b0nouncements/>. Për më tepër shiko: Platforma e organizatave civile për luftën kundër korrupsionit Nominimi i anëtarëve në Komisionin për zbatimin e zgjedhjeve të Këshillit Gjyqësor, në: <https://www.antikorupcija.mk/%D0%B0%D1%80%D1%85%D0%B8%B2%D0%B8/1585>



# EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR



## SHKARKIMI DHE ZGJEDHJA E KRYETARIT TË KGJRMV-SË

Më 26 prill 2023, ish -kryetarja e Këshillit Gjyqësor Vesna Dameva u shkarkua nga funksioni. Në seancë filluan mosmarrëveshjet, pasi ish-nënkryetari Selim Ademi, në kundërshtim me Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pas miratimit të rendit të ditës, kërkoi që të shtohet një pikë për shkarkimin e kryetares së Këshillit Gjyqësor, e cila në mënyrë të argumentuar nuk prano ta hedhë pikën e propozuar në votim. Mosmarrëveshjet arritën kulmin në momentin kur nënkryetari Selim Ademi mori kryesimin e seancës dhe bëri thirrje për votim për shkarkimin e ish-kryetares, me 6 anëtarë të tjerë që e mbështetën, gjë pas së cilës ai konstatoi se Dameva është shkarkuar dhe në prani të saj mori drejtimin e mëtejshëm të seancës. Një nga arsyet pse anëtarët treguan gatishmëri për ta shkarkuar atë është shkelja e marrëdhënieve ndërpersonale në KGJRMV-së, gjegjësisht, sepse ish-kryetarja Vesna Dameva nuk e kishte vënë në kohë në rend të ditës shqyrtimin e letrës drejtuar KGJRMV-së nga ambasadorja amerikane Anxhela Ageler, duke dhënë arsye të argumentuara për veprimin e saj. Gjithashtu, u theksuan pretendime të tjera që çuan në prishjen e marrëdhënieve, por pa prova konkrete, për të cilat kryetarja ka insistuar që t'i vihen në dukje.

**Kjo procedurë është një precedent në punën e KGJRMV-së që nga themelimi i tij e deri më tani.** Veçanërisht i habitshëm është veprimi i anëtarëve të caktuar të KGJRMV-së, të cilët këmbëngulnin për futjen dhe diskutimin për pikën e rendit të ditës për shkarkimin e kryetares të KGJRMV-së dhe njëkohësisht për të vendosur për të, pa u kushtuar vëmendje aspekteve ligjore, për më tepër që në Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>5</sup> (LKGJRMV), nuk ka paraparë procedurë për shkarkim të kryetarit të Këshillit Gjyqësor. Përgjegjësia e anëtarit të Këshillit Gjyqësor parashikohet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, me dispozita specifike për përgjegjësinë disiplinore të një anëtarit të Këshillit Gjyqësor, duke specifikuar arsyet për paraqitjen e kërkesës për procedim disiplinor për një anëtar të Këshillit. Parashikohet edhe procedura për vendosje në bazë të kërkesës për fillim të procedurës disiplinore për një anëtar të KGJRMV-së. Megjithatë, asnjë dispozitë e Ligjit nuk parashikon një procedurë për shkarkimin e kryetarit të Këshillit Gjyqësor ose për shkarkimin e një anëtarit të Këshillit Gjyqësor për shkaqe të tjera, përveç kur bëhet fjalë për përcaktim të përgjegjësisë disiplinore. As Rregullorja e punës së KGJRMV-së nuk përmban dispozita që rregullojnë procedurën ose arsyet e shkarkimit të kryetarit të Këshillit Gjyqësor. Rregullimi i pamjaftueshëm i dispozitave të caktuara ligjore nuk do të thotë dhe trajtim joadekuat, gjegjësisht jep një mundësi për interpretim arbitrar të dispozitave ekzistuese, gjë e cila dhe ndodhi. Nëse qëllimi i Këshillit Gjyqësor ka qenë shkarkimi i ish-kryetares Vesna Dameva, duke përdorur analogjinë e shkarkimit të një gjyqtari, vetë akti i shkarkimit kundërshtohet, për arsye se LKGJRMV parasheh se për shkarkimin e një gjyqtari është e nevojshme të votojnë 8 anëtarë nga anëtarët e pranishëm me të drejtë vote. Në rastin konkret, kanë votuar 7 anëtarë, përfshirë propozuesin- ish-nënkryetarin Selim Ademi, i cili

<sup>5</sup> Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.102/2019

do të duhej të përjashtohet nga votimi, pa diskutim paraprak dhe pa respektuar procedurën që zbatohet për shkarkimin e gjyqtarit. Edhe në punën e deritanishme të Këshillit Gjyqësor, në seancat publike, ka pasur mosmarrëveshje midis anëtarëve për dispozita të caktuara ligjore, veçanërisht kur ato nuk janë parashikuar qartë dhe në mënyrë koncize me ligj ose akt nënligjor, por kurrë nuk ka ndodhur që Këshilli Gjyqësor të marrë një vendim që nuk është parashikuar me ligj ose procedura e të cilit nuk është e rregulluar ligjërisht.

Në ditët pas shkarkimit të ish-kryetares Vesna Dameva, anëtarët e Këshillit Gjyqësor gjetën një mënyrë për të "legalizuar" përsëri sjelljen e tyre të paligjshme duke shkelur dispozitat ekzistuese në LKGJRMV-së, të cilat i referohen qasjes së publikut në punë. Përmes një vendimi unanim nga anëtarët e pranishëm për të mbajtur dy seanca, dhe pas kolegji-umeve, që ishin të mbyllura për publikun, në të cilat e shfuqizuan vendimin e mëparshëm për shkarkimin e ish-kryetares Vesna Dameva, ata ranë dakord të rifillojnë një procedurë për shkarkimin e saj dhe kështu të zgjidhin situatën e krijuar, por këtë herë duke siguruar dy vota të tjera pro shkarkimit të saj. **Ish-kryetarja Vesna Dameva, për herë të dytë në një procedurë të parregulluar, u shkarkua nga posti i saj më 4 maj 2023.**

**Në të njëjtën seancë, më 4 maj 2023, u zgjodh kryetari i Këshillit Gjyqësor me 8 vota "për" dhe 4 "kundër".** Seanca në të cilën u zgjodh kryetari i ri Sashko Georgiev u thirr nga ish-nënkryetari i KGJRMV-së, Selim Ademi, në mënyrë të pazakontë, jashtë orarit të punës së KGJRMV-së, pesëmbëdhjetë minuta para fillimit të seancës, që tregon një shpërfillje të drejtpërdrejtë të dispozitave ligjore që lidhen me qasjen e publikut në punën e KGJRMV-së. Në bazë të dispozitave të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 39), seancat janë publike, dhe publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të KGJRMV-së, i cili duhet të miratohet në seancë publike, me qëllim të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose kandidatit për gjyqtar. Për përjashtimin e publikut, Këshilli Gjyqësor vendos me 2/3 shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KGJRMV-së me të drejtë vote. Në rast se Këshilli Gjyqësor ka vendosur përjashtimin e publikut, kryetari i KGJRMV-së është i detyruar të njoftojë publikun për arsyet e përjashtimit dhe në rast se në seancë merret vendim me votim, votimi i vendimit bëhet publik. Në bazë të nenit 38 të LKGJRMV-së dhe nenit 11 të Rregullores së punës së KGJRMV-së, dita e mbajtjes së seancës së Këshillit Gjyqësor publikohet në faqen e internetit të KGJRMV-së menjëherë pas caktimit të seancës, njëkohësisht me dorëzimin e ftesës drejt anëtarëve të KGJRMV-së. Ftesa dorëzohet të paktën 7 ditë para ditës së seancës, por ekziston mundësia, për shkak të çështjeve urgjente, që seanca të caktohet brenda një periudhe më të shkurtër.

Megjithatë, për dy seancat, të mbyllura për publikun, media dhe publiku kanë marrë informacionin nga një anëtar i KGJRMV-së në seancën ku u zgjodh kryetari i ri. Duhet theksuar se njoftimet nga këto seanca të mbyllura u publikuan në faqen e internetit pas seancës publike, në të cilën u zgjodh kryetari i KGJRMV-së dhe pas reagimeve të dhunshme të publikut të pranishëm në seancën për "punën e fshehtë të anëtarëve të KGJRMV-së".<sup>6</sup>

---

6 Më shumë rreth transparencës në kapitullin "transparenca" të këtij raporti (f.3).



## ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR NGA RADHËT E GJYQTARËVE

Zgjedhja e kryetarit të ri të KGJRMV-së nuk arriti të përmirësojë situatën në Këshill për arsye se më 8 qershor 2023, dy anëtarë të KGJRMV-së paraqitën dorëheqje të parevokueshme. Arsyet për dorëheqjet e anëtarëve u shpjeguan nga gjyqtarja Mirjana Radevska Stefkova nga GJSRMV, dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkup, Zoran Gerasimovski, përveçse me shkrim, edhe në një seancë në prani të publikut, duke vënë në dukje se një vendim i tillë është marrë për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me mënyrën e punës dhe vendim-marrjes të Këshillit Gjyqësor.

Pas konstatimit të dorëheqjeve, u mor vendimi të publikohen shpallje për zgjedhje të anëtarëve të rinj. Pas dorëheqjeve të dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve, filloi procedura për zgjedhjen e anëtarëve të rinj nga radhët e gjyqtarëve, përkatësisht një anëtar i Gjykatës Supreme dhe një anëtar i Qarkut të Apelit të Shkupit në gjykatat administrative.

Lidhur me kandidaturat, mund të konstatohet se vetëm një kandidat, gjyqtari Naqe Georgiev, është paraqitur në Gjykatën Supreme të rrethit zgjedhor, dhe vetëm kandidatja Antoaneta Dimovska, gjyqtare e Gjykatës Themelore Civile, është vërtetuar për zonën zgjedhore Apeli Shkup dhe gjykatat administrative. Duke pasur parasysh se kishte një kundërshtim nga gjyqtari Llazar Nanev, kryetar i Gjykatës themelore Kavadar, i cili paraqiti një kërkesë, por ajo nuk u pranua nga Komisioni për përgatitjen e listave të kandidatëve pas shpalljes për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, gjatë përcaktimit të kandidaturave të gjyqtarëve kandidatë të regjistruar, Këshilli Gjyqësor diskutoi dokumentet që do të dorëzohen nga secili kandidat që konkurron pas një shpalljeje të publikuar për zgjedhje si anëtar i Këshillit Gjyqësor, e cila thuhet në vetë njoftimin, dhe është në përputhje me Ligjin për Këshillin Gjyqësor.

Gjegjësisht, brenda afatit të përcaktuar, kandidati Llazar Nanev nuk kishte dorëzuar dokumente origjinale për stazhin, si dhe vërtetim për orët e përfunduara të trajnimit në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, por kopje të tyre. Në ankesën e paraqitur nga ana e tij, ai ka siguruar prova origjinale, me shpjegime dhe ka dërguar e-mail në lidhje me arsyet e dorëzimit kopjeve gjatë dorëzimit të dokumenteve. Në seancën e mbajtur është konstatuar sjellja jokonsistente e anëtarëve të KGJRMV-së në lidhje me “formalizmin” e tyre rreth pranimit të kushteve për plotësimin e dokumenteve tatimore të kërkuara për kandidim për anëtarësim në KGJRMV, pasi para disa muajve Këshilli Gjyqësor ka pranuar kandidatë të cilët nuk kishin dorëzuar dokumente origjinale.

Gjegjësisht, disa prej anëtarëve kanë mbetur me qëndrimin se, edhe pse ligji përcakton se cilat dokumente duhet të paraqesë kandidati, kjo nuk është diçka e domosdoshme, sepse Këshilli Gjyqësor ka të dhëna për çdo gjyqtar sa i përket stazhit, gjëra që komisioni i di dhe që janë pjesë përbërëse e dosjeve të secilit gjyqtar, kështu që nuk duhen kërkuar për dorëzim. Nga ana tjetër, disa anëtarë besojnë se edhe pse Këshilli Gjyqësor është i njohur me të dhënat që kërkohen për t'u dorëzuar gjatë aplikimit për një shpallje konkrete, secili kandidat është i detyruar ta bëjë këtë, pasi është një detyrim ligjor.

**Pas miratimit të ankesës së gjyqtarit Llazar Nanev me shumicë votash, u përcaktuan listat e kandidatëve, si rrjedhojë për Qarkun e Apelit të Shkupit dhe gjykatat administrative kandidatë për anëtarë të KGJRMV-së ishin Antoaneta Dimovska dhe Llazar Nanev.**

Lidhur me kandidatin - gjyqtarin Naqe Georgiev, në media kishte shumë informacione në lidhje me procedurën e filluar nga KGJRMV për punën e tij joprofesionale dhe të pandërgjegjshme, si dhe procedurën para prokurorisë për veprime korruptuese gjatë kryerjes së funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Themelore të Strumicës dhe në Gjykatën e Apelit të Shtipit. Kandidatura e Naqe Georgiev u ndoq me interes të veçantë nga publiku dhe media, dhe një nga arsyet ishte se pas publikimit të listës së kandidatëve, në faqen e internetit të KGJRMV-së, ku u propozua Naqe Georgiev, deri në miratimin përfundimtar të listës, u mbajt një seancë e KGJRMV-së, në të cilën një nga pikat në rendin e ditës ishte shqyrtimi i raportit për situatën e konstatuar. Duke pasur parasysh se ky lloj shqyrtimi dhe vendimi mbi këto çështje është i mbyllur për publikun, në media u vendos informacion se pikërisht ajo pikë në rendin e ditës i referohej pezullimit të procedurës së përgjegjësisë për gjyqtarin Naqe Georgiev para KGJRMV-së, i cili është kandidati i vetëm nga Gjykata Supreme për anëtar të KGJRMV-së.

**Pas zgjedhjeve, më 13 korrik 2023, u zgjodhën dy anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve, përkatësisht Naqe Georgiev, gjyqtar nga Gjykata Supreme e rrethit zgjedhor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe Antoaneta Dimovska, gjyqtare e Gjykatës Themelore Civile Shkup, përfaqësuese nga Qarku i Apelit Shkup dhe gjykatat administrative. Procedura e përzgjedhjes u zhvillua në përputhje me dispozitat ligjore, përfshirë dispozitën për publikimin e rezultateve të përzgjedhjes, e cila u krye publikisht me transmetim të drejtpërdrejtë nga MIA. Megjithatë, duhet të theksohet se këto zgjedhje ishin të një rëndësie të veçantë për mediat, për shkak të faktit se **kandidati Naqe Georgiev u zgjodh me vetëm 6 vota nga 16 vota nga GJSRMV**. Konkretisht, nga raporti i Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve në drejtorinë e zgjedhjeve gjyqësore janë regjistruar 16 gjyqtarë që kishin të drejtë vote, nga të cilët 6 gjyqtarë kanë votuar duke rrumbullakuar kandidatin, 3 gjyqtarë nuk kanë votuar fare dhe 7 fletëvotime janë të pavlefshme. Theksojmë se në fletëvotim nuk ka asnjë mundësi për të votuar “për” ose “kundër”. Në Ligjin për KGJRMV nuk ka dispozita që rregullojnë regjistrimin e numrit të gjyqtarëve që do të votojnë, si dhe numrin e kërkuar të votave për të konsideruar kandidatin të zgjedhur. Mirëpo, mungesa e mbështetjes nga kolegët ngre edhe çështjen e përfaqësimit legjitim që ky kandidat duhet të ketë si anëtar i KGJRMV-së.**

**Më 25.7.2023, anëtarët e sapozgjedhur duhej të zhvillonin seancën e tyre të parë pas dorëzimit të betimit në Kuvendin e RMV-së . Por anëtari i KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut Naqe Georgiev dha dorëheqjen, gjegjësisht u tërhoq nga funksioni si anëtar i Këshillit Gjyqësor para fillimit të seancës. Arsyja për këtë ishte zgjedhja e djalit të tij si gjyqtar në gjykatën themelore nga kandidatët e AGJPP-së, e cila u vendos si pikë në rendin e ditës në të njëjtën ditë. Ligji për Gjykatat është shumë i qartë në përcaktimin e kushteve për atë se kush nuk mund të zgjidhet gjyqtar, më saktësisht në nenin 43, paragrafi 4 thuhet se: "një person i cili është i lidhur me një anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë në linjë direkte ose indirekte deri në brezin e tretë, ose bashkëshorti i tij, nuk mund të zgjidhet gjyqtar ose gjyqtar porotë.**

Duke pasur parasysh faktin se djali i gjyqtarit Naqe Georgiev ka përfunduar trajnimin në AGJPP-së, dhe vetëm ata që kanë përfunduar këtë trajnim, sipas ligjit, mund të zgjidhen gjyqtarë në gjykatat themelore, ishte e nevojshme që Naqe Georgiev të dorëhiqej dhe dorëheqja të konstatohet për të shmangur shkeljen nga ana e KGJRMV-së.



## ZGJEDHJA E GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Në këtë periudhë raportuese, pas një kohe të gjatë, është kryer zgjedhja e gjyqtarëve në gjykatë më të lartë. Seanca në të cilën u krye zgjedhja ose ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Gjykatën e Apelit Gostivar ishte me interes të madh për publikun dhe mediat, sepse pas një periudhe të gjatë kohore u zgjodhën ose u ngritën gjyqtarë në detyrë, bazuar në mënyrën e re të gjykimit të gjyqtarëve, të parashikuar nga Ligji për Gjyqësorin i vitit 2019. Pritshmëritë nga Këshilli Gjyqësor për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve ishin të larta, por mund të konkludohet se ato nuk u përmbushën deri në fund.

Gjegjësisht, në seancën për zgjedhjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, të mbajtur më 29.03.2023, u prezantua e gjithë procedura e përzgjedhjes, me theks të veçantë mbi rëndësinë që, pas më shumë se 2 vjetësh ka përfunduar procedura për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Gjykatën e Apelit Gostivar. U theksua se kjo vonesë kishte arsye objektive, mbi të gjitha për faktin se ishte në pritje të miratimit të gjitha rregullave dhe metodologjive<sup>7</sup> që ishin të nevojshme për kryerjen e vlerësimit, i cili është kusht për ngritjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë. Kjo procedurë, në përputhje me dispozitat e përcaktuara, është në vetvete afatgjatë dhe komplekse dhe kërkon mjaft kohë për zbatim.

Në shpalljen për zgjedhjen e gjyqtarëve në GJSRMV, u raportuan pesë kandidatë për zonat penale dhe civile. Në seancë, për secilin kandidat individualisht, u referuan pikët që morën, si për vlerësim cilësor ashtu edhe sasiore sipas secilit kriter të përcaktuar në ligj. Bazuar në pikët e marra nga e gjithë procedura e vlerësimit, u bë një rang-listë, pas së cilës u votua, duke filluar me kandidatin që ishte i pari në rang-listën me numrin më të madh të pikëve. Sipas ligjit, konsiderohet i zgjedhur gjyqtari që do të marrë 8 vota nga anëtarët e KGJRMV-së me të drejtë vote. Kur në shpallje votohet një numër i mjaftueshëm kandidatësh, votimi i mëtejshëm ndërpritet dhe nuk jepet mundësi për të votuar për kandidatët e mbetur dhe për të shteruar të gjithë rang-listën.

Kjo praktikë ka qenë e pranishme në RMV edhe para miratimit të ligjit të ri dhe ka qenë subjekt i kritikave për shkak se kandidatëve të tjerë në rang-listë nuk u është dhënë mundësia për t'u votuar. Kjo ngre pyetjen nëse ndonjë kandidat tjetër nga rang-lista mund të marrë të njëjtat vota ose edhe më shumë vota se anëtarët e KGJRMV-së.

<sup>7</sup> Rregullore për mënyrën e rangimit të kandidatëve për gjyqtarë nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, Rregullore për mënyrën e rangimit të kandidatëve për zgjedhjen e një gjyqtari në një gjykatë më të lartë, Metodologjia për vlerësimin e punës së gjyqtarit bazuar në përmbushjen e kriterëve cilësorë për punë gjyqësore dhe Formular për notimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kriterëve cilësorë për punën e gjyqtarit, Metodologjia për vlerësimin cilësor të kryetarëve të gjykatave dhe Formular për vlerësimin cilësor të kryetarëve të gjykatave, Udhëzime për mënyrën e llogaritjes së orëve efektive të punës, Metodologji me tregues për përcaktimin e kompleksitetit të çështjeve, Rregullore për mënyrën e krijimit të komisioneve për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, Rregullore për formimin dhe punën e Komisioneve të KGJRMV-së për vlerësim të rregullt, në ueb-faqen Судски совет на РСМ.

Në seancë u zgjodhën kandidatët për gjyqtarë në GJSRMV, për zonën civile, të cilët ishin renditur më lart në rang-listë, gjegjësisht ata që kishin numrin më të madh të pikëve, përkatësisht Anita Boshkovska dhe Katerina Georgievska, gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Shkup.

Në të njëjtën seancë, pati një situatë ndryshe, më saktësisht **KGJRMV nuk zgjodhi gjyqtarë për GJSRMV në fushën penale, megjithëse procedura e vlerësimit u zbatua plotësisht dhe u formua rang-lista me pikët e kandidatëve, pa u dhënë sqarime nga ana e anëtarëve që votuan kundër në lidhje me atë se pse nuk votuan për kandidatët e propozuar me numrin maksimal të pikëve.** Është e pakuptueshme se për çfarë arsyesh nuk është votuar një kandidat i caktuar për gjyqtar në një gjykatë më të lartë, duke pasur parasysh nevojën e padiskutueshme për gjyqtarë në atë gjykatë, për të cilën është publikuar shpallja. Më pas u krye një procedurë e plotë vlerësimi, e cila, siç u përmend, është komplekse dhe afatgjatë, u zhvilluan teste dhe intervista me kandidatët dhe në fund, pa asnjë fjalë, shumica e anëtarëve nuk zgjodhën gjyqtarë në GJSRMV.

Lind pyetja, cili është justifikimi për këtë sjellje të anëtarëve të KGJRMV-së? Është e paqartë nëse ka arsye për të cilat publiku nuk është në dijeni e për të cilat KGJRMV është në dijeni, kështu që ndoshta kjo është arsyeja pse kandidatët për gjyqtarë nuk janë përzgjedhur, ose ka arsye të tjera, por KGJRMV nuk guxon të informojë publikun, dhe mbi të gjitha gjyqtarët për veprimet e tilla nga ana e tyre?!

**Zgjedhja e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Gostivar kishte një rrjedhë tjetër. Nga rang-lista, e përgatitur në përputhje me gjithë procedurën e parashikuar për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, nuk u zgjodhën të parët në listë, por u votuan gjyqtari i pestë dhe i gjashtë me radhë.** Aleksandar Milloshevski, gjyqtar i Gjykatës Themelore Penale Shkup dhe Daut Rustemi, gjyqtar i GJTH Gostivar u zgjodhën gjyqtarë të GJA Gostivar.

Mund të konstatohet se anëtarët e KGJRMV-së kanë të drejtë të votojnë për kandidatin që ata besojnë se do të kryejë më së miri funksionin gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Por nga ana tjetër, thelbi i gjithë procedurës së vlerësimit anashkalohet dhe vihet në pikëpyetje. Gjegjësisht, bëhet fjalë për një vlerësim gjithëpërfshirës në të cilin kandidatët për gjyqtarë vlerësohen sipas treguesve të përcaktuar në mënyrë rigoroze dhe marrin vlerësime specifike. Qëllimi i këtij vlerësimi është shmangia e elementit subjektiv të vlerësimit nga anëtarët e KGJRMV-së, sigurimi i zbatimit të plotë të sistemit të meritës, si dhe vlerësimi i cilësisë së punës së gjyqtarëve të kryhet nga kolegët e tyre nga një gjykatë më e lartë dhe në këtë mënyrë të garantohet zgjedhja e pavarur dhe e paanshme e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë.

Padyshim që anëtarët e KGJRMV-së kanë të drejtë të zgjedhin gjyqtarë nga rang-lista, gjegjësisht të mos bëjnë zgjedhje, por kjo minon besimin e gjyqtarëve në pavarësinë e KGJRMV-së dhe i dekurajon ata të aplikojnë për shpallje, të përpiqen për të arritur nota të shkëlqyera dhe pastaj, pa shpjegime nga anëtarët e KGJRMV-së, thjesht të mos votohen. Lind pyetja nëse kjo nuk është një nga mënyrat që KGJRMV të marrë kandidatë që janë "të dëshirueshëm" për t'u promovuar në gjykatat më të larta? Arsyeja është më shumë se nuk ka përgjegjësi specifike për anëtarët, kur ata nuk ushtrojnë kompetencën e tyre themelore, që është zgjedhja dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve. **Veprime të tilla të papërgjegjshme nga KGJRMV ndikojnë në besimin e qytetarëve, vënë në pikëpyetje qasjen në drejtësi, dhe më e rëndësishmja, lënë gjykatat më të larta pa aftësi të mjaftueshme për të kryer funksionin e tyre në kohën e duhur.**

Sipas ligjit, anëtarët e KGJRMV-së janë të detyruar të japin shpjegim vetëm për kandidatët që kanë zgjedhur si gjyqtarë, domethënë i kanë ngritur në detyrë. Shpjegimet e tyre konsistojnë në përsëritjen e pretendimeve të bëra nga kryetari i Komisionit i ngarkuar me përmbledhjen e vlerësimeve dhe përgatitjen e rang-listës. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve e njuh gjyqtarin në fjalë, për shkak se ai vjen nga një gjykatë apo zonë e caktuar e apelit, atëherë tregohen cilësi të tjera, si integriteti, vlerat morale dhe etike, ndërgjegjja dhe profesionalizmi, por vetëm si floskula të përgjithshme.

**Kur përzgjidhet kandidati i parë në rang-listë, theks të veçantë u kushtohet pikëve të larta që ka marrë gjatë vlerësimit.** Për anëtarët e KGJRMV-së, ky është një tregues i një kandidati cilësor, i provuar në kryerjen e funksionit të tij. **Por kur zgjidhet një kandidat që nuk është ndër të parët, atëherë tregohen attribute të tjera,** të cilat tashmë janë përmendur në këtë tekst më sipër. Madje përmendet dhe se nuk është paraqitur asnjë ankesë kundër atij kandidati nga qytetarët ose personat juridikë.

Nëse një kandidat nuk zgjidhet në mënyrë unanime, gjyqtarët që nuk kanë votuar për të, më së shpeshti nuk bëjnë komente ose vetëm deklarojnë se besojnë se ai nuk duhet të zgjidhet, pa hyrë në detaje dhe pa dhënë arsye specifike.

Përveç ngritjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta, në këtë periudhë gjashtëmujore, u zgjodhën kryetarët e Gjykatës së Apelit Shkup, Gjykatës Themelore të Prilepit, Gjykatës Themelore të Berovës dhe kryetari i Gjykatës Themelore të Tetovës.

**Situata me zgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë është alarmante.** Gjegjesisht, KGJRMV-ja publikoi një shpallje për zgjedhje të gjyqtarëve në gjykatat themelore, kryesisht për gjykatat më të vogla. Qëllimi i këtij vendimi të Këshillit Gjyqësor ishte plotësimi i vendeve ku mungojnë më shumë gjyqtarët dhe ku prej vitesh nuk është paraqitur askush. Për këto arsye **KGJRMV vendosi së pari të publikojë shpallje në gjykatat më të vogla për të motivuar kandidatët nga AGJPP të aplikojnë në këto shpallje,** ndërsa shpalljet për gjykatat më të mëdha, të cilat sigurisht që ishin me interes të madh, u lanë për më vonë. Pas afatit të regjistrimit në gjykatat më të vogla, **për shkak të mungesës së interesit nga kandidatët e AGJPP-së, u publikua përsëri një shpallje e re, por këtë herë për plotësimin e pozicioneve gjyqësore edhe në gjykatat më të mëdha.**

**Është shqetësuese që në të dyja shpalljet për gjykatat më të vogla nuk kishte kandidatë të interesuar.** Interes më të madh kishte për Gjykatën Themelore Penale Shkup, Gjykatën Themelore Civile Shkup, gjykatat themelore në Manastir, Tetovë, Strumicë dhe Sveti Nikole. Kandidatë për gjykatat më të vogla primare nuk ka, madje as për Gjykatën Themelore në Prilep, e cila nuk është një gjykatë e vogël, ku aktualisht punojnë vetëm 4 gjyqtarë.

**Problemi tjetër lidhet me përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe mungesën e një agjencie të akredituar që kryen testin psikologjik dhe testin e integritetit, që është pjesë e procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve.** Nga Instituti për akreditim, KGJRMV mori njoftim se në RMV nuk ka asnjë institucion të akredituar në përputhje me ligjin, dhe kontratat me kompaninë aktuale Vista Group dhe Institutin për kërkime politike dhe sociologjike, të cilët i kanë kryer këto teste, kanë skaduar. Përkundër disa përpjekjeve, përmes Qeverisë së RMV-së dhe Ministrisë së Drejtësisë, që të theksohet problemi se pa një kompani të akredituar nuk mund të ketë zgjedhje të gjyqtarëve, dhe pas disa muajsh korrespondence, Qeveria, në një seancë, arriti në përfundimin t'i rekomandojë KGJRMV-së që të vazhdojë të punojë me kompaninë aktuale, deri në akreditimin e kompanive të reja që do të jenë në gjendje të kryejnë këtë veprimtari. Pas një mosmarrëveshje të gjatë midis anëtarëve të KGJRMV-së lidhur me çështjen nëse duhet të bllokohet zgjedhja e gjyqtarëve deri në akreditimin e

një kompanie të re apo të punohet “kundër ligjit” me rekomandim të Qeverisë, anëtarët miratuan propozimin për vazhdimin e bashkëpunimit duke lidhur një aneks me kompaninë aktuale që kryente këto shërbime. Qëllimi kryesor i këtij vendimi nuk është pengimi i procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve, jo vetëm të kandidatëve të rinj për gjyqtarë në gjykatat themelore, por edhe të gjyqtarëve që duhet të ngrihen në detyrë në një gjykatë më të lartë. Me rastin e këtij vendimi, një anëtar i KGJRMV-së ka një mendim të veçantë të botuar në faqen e internetit të KGJRMV-së.<sup>8</sup>

**Më 25 korrik 2023 u bënë zgjedhje për gjyqtarë në gjykatat themelore,** gjegjësisht për Gjykatën Themelore Manastir, Gjykatën Themelore Sveti Nikole, Gjykatën Themelore Strumicë dhe Gjykatën Themelore Tetovë. Zgjedhja u bë në bazë të shpalljes së publikuar më 6.4.2023,<sup>9</sup> dhe zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Manastir, Gjykatës Civile Themelore Shkup, Gjykatës Penale Themelore Shkup dhe Gjykatës Themelore Strumicë, pas shpalljes të publikuar më 30.5.2023.<sup>10</sup> Këshilli Gjyqësor, pas përfundimit të procedurës së parashikuar në ligj dhe aktet nënligjore, krijoi një rang-listë të kandidatëve për gjyqtarë për secilën gjykatë individualisht. Kandidatët u renditën sipas pikëve të marra nga AGJPP dhe pikëve të bazuara në intervistën e zhvilluar nga anëtarët e Komisionit të KGJRMV-së. U konstatua se pikët nga rang-lista e kandidatëve nga AGJPP dhe rang-lista përfundimtare e KGJRMV-së nuk dallonin shumë, që do të thotë se kandidatët e kanë treguar suksesin e tyre edhe para Komisionit që e ka kryer intervistën.

**Nga 32 kandidatë për gjyqtarë nga AGJPP, u zgjodhën 25 gjyqtarë.** Për kandidatët e tjerë është lëshuar një shpallje e re në ato gjykata ku ka pasur shumë nevojë për gjyqtarë të rinj, gjë e cila është shpërguar më sipër.



## SHKARKIMI I GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

**Në periudhën deri në qershor 2023, Këshilli Gjyqësor deklaroi ndërprerjen e detyrës gjyqësore për shkak pensionit të moshës për 29 gjyqtarë, një gjyqtari i pushoi funksioni për shkak të vdekjes, ndërsa një gjyqtari tjetër për shkak të kërkesës së tij,** gjë që rriti mungesën e gjyqtarëve në gjykatat primare dhe të apelit. Për këtë problem të madh që ka lindur në gjyqësor, KGJRMV ka diskutuar disa herë në seanca për të gjetur një zgjidhje për kapërcimin e mungesës së gjyqtarëve në të gjitha gjykatat në vend, por, përveç plotësimit të boshllëqeve përmes përzgjedhjes së kandidatëve nga AGJPP dhe përmes delegimit nga një gjykatë në tjetrën, nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të zgjidhur këtë problem, dhe kjo ndikon jo vetëm në afatin kohor të gjykatave, por edhe në sigurimin e qasjes në drejtësi për qytetarët.

8 Mendimi i veçantë i Anëtarit të Këshillit Gjyqësor të RNM, Vesna Dameva, qershor 2023, në: <http://sud.mk/wps/wcm/connect/ssrm/624d50b2-2f63-453d-a4f4-8ba5d31da6dc/%D0%98%D0%B7%D0%B4%D0%B2%D0%BE%D0%B5%D0%BD%D0%BE+%D0%BC%D0%B8%D1%81%D0%BB%D0%B5%D1%9A%D0%B5.pdf?MOD=AJPERES&CVID=>

9 Gazeta Zyrtare e RMV nr.73/2023

10 Gazeta Zyrtare e RMV nr.112/2023;





## MONITORIMI I PUNËS SË GJYKATAVE

Monitorimin e punës së gjykatave KGJRMV e bën duke shqyrtuar dhe vlerësuar raportet tremujore dhe vjetore, por edhe duke vizituar gjykatat nga ana e komisioneve të përbëra nga anëtarë të Këshillit Gjyqësor, gjë e cila parashikohet në Planin e brendshëm për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjykatave, gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave për vitin 2023.

**Raportet tremujore për punën e gjykatave tregojnë se trendi i gjykatave të vjetruara vazhdon, dhe arsyet për këtë situatë janë numri i zvogëluar i gjyqtarëve, numri i pamjaftueshëm i administratës gjyqësore, si dhe rritja e numrit të çështjeve.**

Është praktikë e zakonshme, pas vizitave në gjykata, që anëtarët e komisionit që kanë bërë vizitën të paraqesin raportin e vizitës në një seancë, duke evidentuar gjetjet më domethënëse dhe duke propozuar konkluzione për veprime të mëtejshme, nëse janë evidentuar mangësi në punën e gjykatave apo të disa gjyqtarëve apo kryetarëve të gjykatave. Nëse ka nevojë për një vizitë të jashtëzakonshme në një gjykatë, dhe arsyet për këtë janë rastet gjyqësore me interes publik ose ankesat nga qytetarët ose personat juridikë për situata të caktuara të papërshtatshme në gjykatë, në ato raste bëhet një konkluzion i veçantë ku jepen arsyet për një vizitë të caktuar të jashtëzakonshme në një gjykatë të caktuar. Kështu, **gjatë kësaj periudhe raportuese, janë bërë disa vizita gjyqësore, dhe raportet e atyre vizitave janë paraqitur në seancë.** Kjo praktikë pozitive u krijua nga ish-kryetarja Vesna Dameva.

**Karakteristike janë raportet për atë se kur duhet shkuar në vizitë të jashtëzakonshme, pasi këto vizita bëhen për shkak të situatave, gjegjësisht për shkak të çështjeve me interes të madh për publikun. Të tilla janë raportet nga vizita<sup>11</sup> në Gjykatën Themelore Kumanovë, Gjykatën Themelore Kavadar, Gjykatën Themelore Veles, Gjykatën Themelore Shtip dhe Gjykatën Themelore Tetovë.** Gjegjësisht, në këto raporte konstatohen disa probleme që kanë të bëjnë me ndarjen e lëndëve përmes AKMIS-it, pastaj me përjashtimin e gjyqtarëve, dorëzimin e vendimeve me shkrim, përgatitjen e parakohshme të vendimeve, madje edhe marrëdhëniet ndërpersonale të prishura. Për të gjitha këto situata, **anëtarët e KGJRMV-së, në raporte, propozojnë konkluzione dhe hapa të nevojshëm për rregullimin e situatave dhe gjetjeve të konstatuara.** Është e nevojshme të monitorohet realizimi i këtyre konkluzioneve, veçanërisht sepse konkluzionet që u miratuan nga raporti për vizitën e Gjykatës së Apelit Shkup, vitin e kaluar, ende nuk janë realizuar, dhe i referohen fillimit të procedurave të përgjegjësisë për gjyqtarët që nuk kanë vendosur për çështje me interes të madh për publikun për një periudhë të gjatë kohore dhe që kanë çuar në vjetërsinë e këtyre çështjeve, gjë e cila iu paraqit publikut si një nga arsyet për shkarkimin e ish-kryetares Vesna Dameva.

Disa nga raportet nuk janë shqyrtuar tërësisht, situata për të cilat është marrë një vendim për vizitë të jashtëzakonshme në gjykatën e caktuar. Ky është shembulli i Gjykatës Themelore të Kavadarit, por ka shembuj të tjerë, siç është vizita në Gjykatën Themelore të Velesit, gjatë së cilës u krye një inspektim i punës së një gjyqtari pa emër, për të cilin kishte disa ankesa, dhe u përcaktua arsyeja e mbajtjes së të njëjtit gjyqtar përgjegjës për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme, gjë që më vonë rezultoi në shkarkim. Theksojmë

11 Raportet e vizitave në gjykata nga Këshilli Gjyqësor i RMV-së, në: [http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/izvestai/ostanati-dokumenti!/ut/p/z1/pVTLUqNAFP0VXbBsupt-zy7ImMSMTmJFRukNhaQhIAIpIKHKr7dxHo5JJEnZG7jNfZxz7-VADR-gLqJNikZNVhbRs7UDzUM-ohTJH-h6hKcSDfypz9V46M1GAt73Ofg-gfr\\_z3LyXdnPIAxvZ3eYCgp\\_QQ11XDSrZgmDutyYJsyfHFSvFw5albFpishBG1M3mYMKI9FCKQq](http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/izvestai/ostanati-dokumenti!/ut/p/z1/pVTLUqNAFP0VXbBsupt-zy7ImMSMTmJFRukNhaQhIAIpIKHKr7dxHo5JJEnZG7jNfZxz7-VADR-gLqJNikZNVhbRs7UDzUM-ohTJH-h6hKcSDfypz9V46M1GAt73Ofg-gfr_z3LyXdnPIAxvZ3eYCgp_QQ11XDSrZgmDutyYJsyfHFSvFw5albFpishBG1M3mYMKI9FCKQq)

gjithashtu se në raportin për Gjykatën Themelore Tetovë janë evidentuar mangësi në procedurat e përjashtimit, të cilat janë në kompetencë të kryetarit të gjykatës, dhe më vonë, pa treguar nëse mangësitë janë eliminuar, është kryer zgjedhja e të njëjtit kryetar të Gjykatës Themelore Tetovë.



## VENDIMMARRJA NË BAZË TË ANKESAVE NGA QYTETARËT DHE PERSONAT JURIDIKË

Përfaqësimet nga qytetarët dhe personat juridikë, të cilat paraqiten në KGJRMV dhe që i referohen punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, shqyrtohen dhe zgjidhen rregullisht duke respektuar afatet ligjore.

**Në gjysmën e parë të vitit 2023 janë shqyrtuar rreth 256 ankesa të paraqitura nga qytetarë dhe persona juridikë.**

Këshilli Gjyqësor hedh poshtë shumicën e ankesave si të pabazuara, duke qenë se me ankesat qytetarët, pra personat juridikë, kërkojnë përmbysjen e një vendimi gjyqësor, ngaqë nuk janë të kënaqur me të. Në shumicën e rasteve, Këshilli Gjyqësor konstaton se veprimi mbi çështjen është ankim para gjykatës së shkallës së dytë, ankim në gjykatën nënligjore, kështu që pretendimet në ankesë do të vlerësohen nga gjykata e shkallës së dytë si pretendime ankimore në vendim dhe Këshilli Gjyqësor **nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në vendimet gjyqësore, as për t'i ndryshuar ato, duke mos gjetur arsye për të vepruar në lidhje me ankesat e paraqitura.**

Gjithashtu, mund të vihet re edhe refuzimi i ankesave, ndërsa si arsye kryesore e refuzimit mospasja e fakteve të reja në lidhje me ankesën e paraqitur, pastaj fakti që ankesa tashmë është shqyrtuar në një nga seancat e mëparshme ose për shkak se nuk përmban të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për t'u shqyrtuar.

**Në këtë periudhë gjithashtu vihet re një rritje të numrit të ankesave të bazuara, gjë që është për t'u lavdëruar.** Kjo do të thotë se ankesat janë me më shumë prova nga të cilat gjatë studimit anëtarët e KGJRMV-së, mund të shohin tregues të punës së pandërgjegjshme ose joprofessionale të ndonjë gjyqtari. E rëndësishme për këto ankesa është se, kur bëhet fjalë për një ankesë në të cilën gjyqtari ka tejkaluar afatet për veprim ose për publikimin e vendimit, ose për hartimin e vendimit, anëtarët e KGJRMV-së e konstatojnë këtë. Një nga arsyet e këtij veprimi është se ky qëndrim bie brenda kritereve të vlerësimit të gjyqtarëve, në përputhje me Metodologjinë e vlerësimit të gjyqtarëve. Kështu, në rastet kur shkaqet e paraqitura në ankesa nuk janë të mjaftueshme për të filluar një procedurë për përgjegjësinë e gjyqtarit në fjalë, ankesat e bazuara do të jenë pjesë e vlerësimit të gjyqtarit.

# PËRFUNDIME

---



Në periudhën nga janari deri në korrik 2023, Këshilli Gjyqësor kaloi nëpër disa sfida, të cilat treguan dobësitë jo vetëm në vendimet e parashikuara në LKGJRMV, por edhe në punën e anëtarëve individualisht. Megjithëse periudha e kaluar shënoi procedurën e pasaktë për shkarkimin e ish-kryetares së Këshillit Gjyqësor Vesna Dameva, disa çështje të hapura dhe mospërputhje u vunë re në pjesën tjetër të punës brenda juridiksionit të Këshillit Gjyqësor, dhe e gjithë kjo ndikoi në parametrat për monitorimin e punës së tij.



Shkarkimi i ish-kryetares dhe dorëheqjet e dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor tregojnë parregullsi, por edhe përkeqësim të marrëdhënieve ndërpersonale. Nevojiten ndryshime në LKGJRMV në lidhje me rregullimin e procedurave për shkarkimin e një kryetari dhe për përcaktimin e përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit dhe të kryetarit. Në të njëjtën kohë, duhet pasur kujdes për të vlerësuar justifikimin dhe korrektesinë në përdorimin e një analogjie për çështje dhe procedura që nuk rregullohen me ligj, si dhe zbatimin konsistent të saj.



Këshilli Gjyqësor duhet të respektojë plotësisht standardet e funksionimit transparent. Edhe pse Këshilli Gjyqësor ka ecur mirë vitet e fundit në drejtim të transparencës në punën e tij, në këtë periudhë janë krijuar praktika që bien ndesh me këtë parim. Puna përmes kolegjiave vendimmarrëse që caktohen menjëherë para një seance, caktimi i seancave emergjente që nuk përmbajnë asgjë urgjente në vetvete, caktimi i një seance për zgjedhjen e kryetarit jashtë orarit të punës, mbajtja e seancave që nuk janë njoftuar më parë, mosfunksionimi i sistemit elektronik për regjistrimin e zërit dhe për votim gjatë periudhës së shkarkimit të ish-kryetares, e gjithë kjo është pjesë e praktikave që kanë ndikuar negativisht në transparencën e punës së Këshillit Gjyqësor dhe reputacionin e tij në publik. Gjithashtu, mbeten të hapura pyetjet se pse ndodh kjo, a është për shkak të koordinimit të brendshëm të pamjaftueshëm apo për shkak të shmangies së publikut në vetë seancat?



Këshilli Gjyqësor ka kryer rregullisht punën e tij në lidhje me trajtimin e ankesave, zgjedhjen e gjyqtarëve, vizitën në gjykata, por nuk ka përgatitur një analizë nëse periudha kohore kushtuar ngjarjeve rreth shkarkimit të ish-kryetares dhe zgjedhjes së kryetarit të ri ka ndikuar në punën e Këshillit Gjyqësor sa i përket kësaj kompetence.



Mbeten të hapura disa tema në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin, por edhe reputacionin dhe besimin midis gjyqtarëve dhe publikut, si dhe trajtimin jo konsistent të anëtarëve të KGJRMV-së në zbatimin konsistent të kushteve në lidhje me dokumentet e listuara tatimore që kërkohen për kandidaturën për anëtarësim në KGJRMV.



Specifikimi dhe shqyrtimi i mëtejshëm i situatave specifike në raporte është i nevojshëm, pasi disa nga raportet për vizitat emergjente në gjykata nuk përmbajnë informacion nëse kushtet që ishin arsyeja e vizitës janë hetuar plotësisht. Për këto arsye, nuk ka pasur mundësi të nxirren konkluzione dhe propozime të përshtatshme për të kapërcyer situatat që kanë ndikuar në efektivitetin dhe efikasitetin e punës së KGJRMV dhe gjykatave.



Konstatimi i një numri më të madh të ankesave nga qytetarët si të bazuara mirë është diçka pozitive, pasi Këshilli Gjyqësor mund t'i marrë parasysh ato gjatë përcaktimit të indikacioneve të punës së pandërgjegjshme dhe joprofesionale të ndonjë gjyqtari.



Këshilli Gjyqësor ende nuk zbaton në mënyrë të vazhdueshme rregullat e reja dhe rezultatet e vlerësimit në procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, sipas të cilave ka filluar të punojë në vitin 2023, me qëllim ruajtjen e sistemit të meritës. Gjegjësisht, nga rang-lista, e përgatitur në përputhje me procedurën e parashikuar për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, nuk janë zgjedhur gjyqtarët e rangut të parë, por gjyqtarët e rangut të pestë dhe të gjashtë (siç është rasti në Gjykatën e Apelit në Gostivar), apo nuk janë zgjedhur gjyqtarë fare (siç është rasti me moszgjedhjen e gjyqtarëve penalë në GJSRMV). Megjithëse kjo mundësi jepet nga LKGJRMV, pikërisht për shkak të kritikës, është e nevojshme të kryhet një procedurë e plotë vlerësimi për të ruajtur sistemin e meritave. Kjo minon besimin e gjyqtarëve në pavarësinë e KGJRMV-së, dekurajon gjyqtarët në synimin për të arritur nota të shkëlqyera dhe për të aplikuar për shpallje, dhe gjykatat i detyron të gjykojnë me një numër të reduktuar gjyqtarësh. E gjithë kjo ndikon në efikasitetin, efektivitetin e punës së gjykatave dhe çon në qasje joadekuate në drejtësi për qytetarët.



Si çështje e hapur, gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve, vazhdon të mbetet përfundimi i votimit të mëtejshëm pas përzgjedhjes së një numri të mjaftueshëm kandidatësh sipas shpalljes, si rrjedhojë kandidatëve të tjerë në rang-listë nuk u jepet mundësia për t'u votuar dhe për të arritur një numër më të madh votash. Mungesa e kandidatëve në shpalljet për gjykatat më të vogla, gjë e cila zvarritet për një kohë të gjatë, ndikon në punën e këtyre gjykatave dhe është një çështje që duhet të merret parasysh gjatë miratimit të dokumenteve strategjike dhe ndryshimeve ligjore.



Besimi në Këshillin Gjyqësor, i cili është dukshëm në një nivel më të ulët, duhet të rritet edhe midis vetë gjyqtarëve, tregues i të cilit është interesi i ulët i gjyqtarëve që kandidojnë për anëtarë të Këshillit Gjyqësor. Mungesa e regjistrimit të numrit të gjyqtarëve që do të votojnë, si dhe numri i kërkuar i votave për një kandidat që do të konsiderohet i zgjedhur si anëtar KGJRMV-së, vë në pikëpyetje përfaqësimin legjitim të gjyqtarëve dhe besimin në gjyqësor.



Këto situata vënë në pikëpyetje jo vetëm transparencën, efektivitetin dhe efikasitetin në punën e Këshillit Gjyqësor, por edhe reputacionin e Këshillit Gjyqësor si institucion dhe ushtrimin e kompetencave të rregullta, kujdesin për reputacionin e gjyqtarëve dhe besimin e qytetarëve në gjyqësor.

# REKOMANDIME

---

Bazuar në monitorimin e seancave të hapura të Këshillit Gjyqësor, raporteve për Këshillin Gjyqësor, publikimeve dhe dokumenteve të publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të RMV-së dhe publikimeve në media, mund të bëhen rekomandimet e mëposhtme:



Nevojiten ndryshime legislative për të rregulluar procedurën e përgjegjësisë së anëtarëve dhe kryetarit të KGJRMV-së



Është e nevojshme të plotësohet Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut me dispozita që do të rregullojnë procedurën për shkarkimin e kryetarit të KGJRMV-së në mënyrë që të mos përsëritet praktika e mëparshme e shkarkimit bazuar në dispozita joekzistuese.



Ndryshimet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të nevojshme për të përcaktuar cenzus, përkatësisht pjesëmarrjen e gjyqtarëve në zgjedhjen e anëtarëve të KGJRMV-së, si dhe përcaktimin e shumicës me të cilën kandidati konsiderohet i zgjedhur.



Anëtarët e Këshillit Gjyqësor duhet të zbatojnë në mënyrë të vazhdueshme dispozitat e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve dhe/ose kryetarëve të gjykatave, veçanërisht kur është zhvilluar e gjithë procedura, dhe disa anëtarë të KGJRMV-së duhet të argumentojnë për cilat arsye nuk kanë votuar për asnjë kandidat.



Në periudhën në vijim, Këshilli Gjyqësor duhet të përqendrojë kapacitetet e tij në rritjen e besimit të qytetarëve në gjyqësor përmes një roli proaktiv dhe marrjes së masave për të zvogëluar perceptimin e korrupsionit në gjyqësor, duke rritur bashkëpunimin me të gjitha institucionet që punojnë në këtë fushë dhe duke iu drejtuar publikut të gjerë më shpesh.



Këshilli Gjyqësor duhet të zbatojë vazhdimisht rezultatet e listës së vlerësimit dhe rang-listës gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta.



Këshilli Gjyqësor duhet të punojë për rritjen e besimit të gjyqtarëve përmes zbatimit të vazhdueshëm të dispozitave ligjore.

